

OPTIMA COMMUNICATION SH.P.K.
NUIS K71903025A
Tiranë, Shqipëri
PASQYRA FINANCIARE 2024

**Pasqyrat Financiare
dhe Shënimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024**

OPTIMA COMMUNICATION SH.P.K.
NUIS K71903025A
Tiranë, Shqipëri
PASQYRA FINANCIARE 2024

PËRMBAJTJA

FAQJA


PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-17



Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Vlerat janë shprehur në LËK)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	39,502,115	10,984,977
Kërkesa për arkëtim tregtare	5	26,445,526	10,227,088
Kërkesa të tjera tatimore në doganë	6	1,108	-
Inventarë	7	4,312,582	7,042,315
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	1,386,233	2,556,068
Totali i aktiveve afatshkurtra		71,647,564	30,810,448
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	5,233,623	4,134,884
Të tjera kërkesa për arkëtim	10	7,476,408	6,424,608
Totali i aktiveve afatgjata		12,710,031	10,559,492
Totali i aktiveve		84,357,595	41,369,941
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	28,698,859	6,501,858
Detyrime tatimore	12	5,251,389	464,331
Të tjera detyrime	13	292,320	515,191
Parapagime dhe të ardhura të shtyra	14	487,717	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		34,730,285	7,481,380
Detyrimet afatgjata			
Detyrime financiare – afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	15	2,100,000	2,100,000
Rezerva ligjore, statutore	15	1,000,000	1,000,000
Fitim /(Humbje) të mbartura	15	30,788,561	23,242,657
Fitim /(Humbje) e vitit	15	15,738,749	7,545,904
Totali i kapitalit		49,627,310	33,888,561
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		84,357,595	41,369,941


Shënimet shpjeguese në faqet 7-17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
3

Pasqyra e performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
I. Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	103,384,404	56,238,579
Të ardhura të tjera	16	1,531,518	451,090
Total të Ardhurat (I)		104,915,922	56,689,669
II. Shpenzime			
Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara	17	(76,401,444)	(39,351,816)
Shpenzime të personelit	18	(3,704,022)	(3,463,265)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19	(2,455,932)	(1,993,543)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	9	(1,149,761)	(1,469,032)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(2,302,695)	(658,807)
Total shpenzimet		(86,013,854)	(46,936,463)
Fitim Humbja nga veprimtaritë kryesore (I+II)		18,902,068	9,753,207
III. Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	20	(291)	-
Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit	20	(198,471)	(705,733)
Komisione Banke	20	(110,977)	(126,609)
Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)		(309,739)	(832,342)
Fitimi para tatimit (I+II+III)		18,592,329	8,920,865
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	21	(2,853,580)	(1,374,961)
Fitimi (Humbja) e Vitit		15,738,749	7,545,904
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja		-	-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-	-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-	-
Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Fitim/(humbje) i atribueshem për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		15,738,749	7,545,904
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Fitimi/(humbja) për vitin		15,738,749	7,545,904
Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		15,738,749	7,545,904
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		15,738,749	7,545,904

Shënimet shpjeguese në faqet 7-17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Kapitali i regjistruar	Reserva ligjore	Fitime të mbajtura	TOTAL
Balanca e hapjes				
Më 01 Janar 2023	2,100,000	1,000,000	23,242,657	26,342,657
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	-	7,545,904	7,545,904
Shtim Kapitali	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	2,100,000	1,000,000	30,788,561	33,888,561
Transferim ne reserve	-	-	-	-
Dividente të paguar	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	2,100,000	1,000,000	30,788,561	33,888,561
Më 01 Janar 2024	2,100,000	1,000,000	30,788,561	33,888,561
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	-	15,738,749	15,738,749
Shtim Kapitali	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	2,100,000	1,000,000	46,527,310	49,627,310
Transferim ne reserve	-	-	-	-
Dividente të paguar	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	2,100,000	1,000,000	46,527,310	49,627,310

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



5

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi pas tatimit	15,738,749	7,545,904
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	1,149,761	1,469,032
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	16,888,510	9,014,936
Zvogëlimi / (rritja) e inventarëve	2,729,733	(1,527,035)
Zvogëlimi / (rritja) e kërkesave për arkëtim	(17,271,346)	(312,089)
Zvogëlimi / (rritja) e kërkesave për parapagime	1,169,835	(278,343)
(Zvogëlimi) / rritja e llogarive të pagueshme	27,248,906	1,448,289
	30,765,638	8,345,758
Interes i arkëtuar	-	-
Tatim fitimi i paguar	-	-
Paraja neto nga aktivitetet operative (I)	30,765,638	8,345,758
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(2,248,500)	(2,956,408)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	(2,248,500)	(2,956,408)
Flukse monetare nga veprimtaritë financiare:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	-
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	-	-
Arkëtime nga përdorimi i kredisë kufi	-	-
Paraja neto veprimtaritë financiare	-	-
Pakësimi neto i mjeteve monetare	28,517,138	5,389,350
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	10,984,977	5,595,627
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	39,502,115	10,984,977

Shënimet shpjeguese në faqet 7-17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator
Elton Rama

Hartuesi i pasqyrave financiare

Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Optima Communication sh.p.k. (referuar si “Optima” ose “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 26 dhjetor 2006.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në import-eksport, tregti me pakice-shumice, konsulence, projektim, dizenjim, implementim, testim, prodhima, riparim, mirembajtje, monitorim, dhenie me qira dhe shërbime dhe/ose realizime inovatore për produkte dhe/ose sisteme në fushat: grafike krijuese, digjitalizim, printim-shtypshkrim, media audiovizive, evente, marketing, promocion, teknologji informacioni dhe komunikimi, informatike, elektronike, elektrike, energjitike, telekomunikacion, software-hardware, internet, programe kompjuterike, aplikacione, alarm dhe siguri, kamera, akses kontroll, optike, konsum, kancelari, tonera, mobilieri dhe pajisje për zyra, ushqimore, industriale, tekstile, bujqesi dhe blegtori, bime medicinale, laborator, mjekesi, farmaceutike, mekanike-hidraulike, automjete, ndertim, pastrim-gjellërim, higjienë, komisione të ndërmjetësimit tregtar etj dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizenjim.

Shoqëria zotërohet 99.05 % nga ortakët Z. Elton Rama, dhe 0.95 % nga ortakët Z. Niko Qirici.

Vlera e kapitalit themelues është 2,100,000 Lekë, e ndarë në 2 kuota me vlerë nominale respektivisht 2,080,000 lekë dhe 20,000 lekë për kuotë.

Administratori i Shoqërisë është Z. Elton Rama. Shoqëria disponon ambjente në Tiranë që ndodhen në Rruga Shyqyri Berxolli, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/4, Dera 27B, Tiranë, Shqipëri.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 5 (pesë).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar (SKK) dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar duke filluar nga 1 janar 2015. Në bazë të urdhrit nr. 134 datë 21.07.2021 “Për ndryshimin e referencës ligjore të standardeve kombëtare të kontabilitetit”, Ministria e Financave vendosi ndryshimin e referencës ligjore për Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në përputhje me Ligjin 25/2018 duke filluar nga 1 janari 2019.


Në bazë të urdhrit nr. 16 datë 09.02.2024 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre SKK 2023”, Ministria e Financave vendosi të shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përditësuar në vitin 2023 (SKK 2023). Përditësimet e SKK 2023 kanë datë efektive nga 1 janari 2025 dhe aplikohen në perspektivë pa ndryshime të raportimeve të periudhave të mëparshme.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përfshirje të rasteve kur përcaktohet ndryshe.



2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të performancës të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe hazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshtatur më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet


Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Monedha	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EUR/Lek	98.15	103.88
USD/Lek	94.26	93.94

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e performancës. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.


Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e performancës çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e performancës janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e performancës.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktiviteti afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Metodat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Lineare	20%
Pajisje Informatike	Lineare	25%
Mjete transporti e të tjera	Lineare	20%
Aktive afatgjata jomateriale	Lineare	5%

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjesëtim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e performancës nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfutur njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

për vitin 2024 është 15% (2023: 15%). Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve pasqyrës së pozicionit financiar, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Administrator
Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse dhe arkë:		
Leke	39,084,095	9,417,421
Euro	418,020	1,567,556
TOTALI	39,502,115	10,984,977

5. KËRKESA PËR ARKËTIM TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Klientë	26,445,526	9,765,988
Klientë për fatura të lëshuara vitin pasardhës	-	461,100
TOTALI	26,445,526	10,227,088

6. KËRKESA PËR ARKËTIM TATIMORE

Kërkesat për arkëtim tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kërkesa të tjera tatimore në doganë	1,108	-
TOTALI	1,108	-

7. INVENTARË

Shoqëria ka inventarë gjëndje më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mallra për rishitje	4,312,582	6,579,186
Inventarë të tjera	-	463,129
TOTALI	4,312,582	7,042,315


8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime të dhëna	1,352,178	2,268,053
Shpenzime për t'u shpërndarë	34,055	288,015
TOTALI	1,386,233	2,556,068

9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

	Pajisje zyre, mobilitet	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike				
Teprica më 1 Janar, 2024	294,110	5,404,593	1,157,436	6,856,139
Shtesa nga blerjet		358,500	1,890,000	2,248,500
Pakësime				-
Teprica më 31 Dhjetor, 2024	294,110	5,763,093	3,047,436	9,104,639
Amortizimi akumuluar				
Teprica më 1 Janar, 2024	(212,195)	(1,351,623)	(1,157,436)	(2,721,255)
Shtesa	(23,153)	(1,032,108)	(94,500)	(1,149,761)
Pakësime				-
Teprica më 31 Dhjetor, 2024	(235,349)	(2,383,731)	(1,251,936)	(3,871,016)
Balanca më 31 Dhjetor, 2024	58,761	3,379,362	1,795,500	5,233,623

10. KËRKESAT E TJERA PËR ARKËTIM

Kërkesat e tjera për arkëtim më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kërkesa të tjera për arkëtim	6,424,608	6,424,608
Kërkesa të tjera për arkëtim palë të lidhura	1,051,800	-
TOTALI	7,476,408	6,424,608

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	26,968,377	5,023,331
Furnitorë për fatura të pambërritura	1,730,482	-
Parapagime	-	1,478,527
TOTALI	28,698,859	6,501,858

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tatim mbi të ardhurat personale	16,588	10,892
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	73,821	39,333
Tatim mbi vlerën e shtuar	3,551,495	350,948
Tatim në burim	36,000	-
Tatim mbi fitimin	1,573,485	63,158
TOTALI	5,251,389	464,331

13. TË TJERA DETYRIME

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

Teprica e zerit të tjera detyrime më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paga dhe shpërblime	292,320	515,191
TOTALI	292,320	515,191

14. PARAPAGIME DHE TË ARDHURA TË PERIUDHAVE TË ARDHSHME

Parapagime dhe të ardhura të periudhave të ardhshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura të periudhave të ardhshme	487,717	-
TOTALI	487,717	-

15. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është në shumen 2,100,000 Lek.

16. TË ARDHURAT

Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga shitja e punimeve dhe shërbimeve	56,040,802	19,370,409
Të ardhura nga shitje e mallrave	47,343,602	36,868,170
Të ardhura të tjera	1,531,518	451,090
TOTALI	104,915,922	56,689,669

Rakordim i shifrës së afarizmit me FDP 2024:

I. Deklarimi sipas Librave (FDP)	
Shitje të tatueshme	103,186,076
Shitje të përjashtuara	1,200,139
TOTAL	104,386,215
II. Deklarimi sipas PF	
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	104,915,922
TOTAL	104,915,922
DIFERENCA I-II	529,707
III - Rakordim Diferenca	
+ Të ardhura të faturuara në 2023 po të njohura në 2024	121,912
- Të ardhura të faturuara në 2024 po të njohura në 2023	(461,100)
- Të ardhura të faturuara në 2024 po të njohura në 2025	(487,717)
- Parapagime	1,356,615
- Rrumbullakosje/ Diferenca nga kurset	(3)
TOTAL	529,707



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

17. SHPENZIME DIREKTE PËR MALLRAT DHE SHËRBIMET E REALIZUARA

Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Blerje Shërbime design (video/ grafike/ evente)	36,138,564	16,407,818
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	40,262,880	22,943,998
TOTALI	76,401,444	39,351,816

18. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Pagat e personelit	3,307,070	3,093,442
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	396,952	369,823
TOTALI	3,704,022	3,463,265

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzim certifikimi	95,791	108,500
Shërbime mirëmbajtje dhe sigurimi	213,845	212,238
Shpenzime kancelatike	133,047	253,613
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	94,477	35,358
Shërbime qira	1,708,974	536,378
Shërbime konsulence financiare/marketing	209,798	847,456
Shpenzime të tjera	972,998	658,807
Transferime udhetime dhe dieta	852,000	-
Shpenzime për sponsorizime	477,697	-
TOTALI	4,758,627	2,652,350

20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga interesa bankare	-	-
Shpenzime për interesa	(291)	-
	(291)	-

(291)

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

Fitime të realizuara nga kursi këmbimit	108,672	169,444
Humbje të realizuara nga kursi këmbimit	(307,143)	(875,177)
	(198,471)	(705,733)
Komisione bankare	(110,977)	(126,609)
TOTALI	(309,739)	(832,342)

21. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitimi (humbja) e vitit	18,592,329	8,920,863
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	431,537	245,545
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	19,023,866	9,166,408
Shpenzimi aktual për tatim fitim	(2,853,580)	(1,374,961)
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	16,170,286	7,791,447
Parapagime Tatim Fitimi	1,280,095	1,311,803
TF i (pagueshëm)/kreditor	(1,573,485)	(63,158)

Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të adhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2024 (2023: 15%). Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më __ Mars 2025.

Administrator
Elton Rama

